

## **AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “AJ99 Sport and Cultural Management” shpk,**

Në Tiranë, sot më datë 20.03.2023, ne te poshtëshënuart:

Segun James Adeniyi lindur ne Nigeri me 20.12.1992,shtetas Shqiptar i identifikuar me pasaporte shqiptare me numer personal J21220117E, Olaoynikan Michael Ogunlana lindur ne Nigeri, shtetas Nigerian i identifikuar me pasaporte me numer A12300113, Chukwuka Charles Ofojeh lindur ne Nigeri me 26.07.1985, shtetas Shqiptar i identifikuar me karte identiteti me numer personal I50726190D, Fathiat Oyindamola Adeniyi lindur ne Nigeri,shtetas Nigerian,i identifikuar me pasaporte me numer B00978632 ; me cilësinë e “ortakeve themelues”deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojme shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“AJ99 Sport and Cultural Management” shpk,**

### **Neni 1 Emri, Forma**

Shoqëria do të ketë emrin**“AJ99 Sport and Cultural Management” shpk,** dhe formë ligjore: **“Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”** e quajtur më poshtë **“Shoqëria”.**

### **Neni 2 Personaliteti juridik**


Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

### **Neni 3 Selia**

Shoqëria **“AJ99 Sport and Cultural Management” shpk** e ka seline në adresë: **“Rruga Myslym Keta Ndertesa Nr 31,ap 1,Njesia 4.Tirane”** dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

### **Neni 4 Objekti i veprimtarisë**

Objekti i ushtrimit të veprimtarise per shoqërine **“AJ99 Sport and Cultural Management” shpk** është: **“Menaxhim Sporti,ndermjetesim mes klubeve ne shqiperi dhesportisteve,komunikim etj”**



**Neni 5**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

**Neni 6**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100,000 lekë, i ndarë në 4(kater) kuote te cilat zotërohet si më poshtë:

Segun James Adeniyi lindur ne Nigeri me 20.12.1992,shtetas Shqiptar i identifikuar me pasaporte shqiptare me numer personal J21220117E,zoteron 1(nje kuote) me 50% te aksioneve:

Olaoyinkan Michael Ogunlana lindur ne Nigeri, shtetas Nigerian i identifikuar me pasaporte me numer A12300113,zoteron 1(nje kuote) , me 20% te aksioneve:

Chukwuka Charles Ofojeh lindur ne Nigeri me 26.07.1985, shtetas Shqiptar i identifikuar me karte identiteti me numer I50726190D, ,zoteron 1(nje kuote) me 10% te aksioneve:

Fathiat Oyindamola Adeniyi lindur ne Nigeri,shtetas Nigerian,i identifikuar me pasaporte me numer B00978632 , ,zoteron 1(nje kuote) me 20% te aksioneve:

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**


Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



## Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## Neni 9 Administrimi


Administrator i shoqërisë "**AJ99 Sport and Cultural Management**" shpk është:  
Chukwuka Charles Ofojeh lindur ne Nigeri me 26.07.1985, shtetas Shqiptar i identifikuar me karte identiteti me numer I50726190D.

Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar. Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqërisë qe eshte data 20.03.2023.Afati i emerimit te administratorit eshte deri me 20.03.2028.

## Neni 10 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.




**Neni 11**  
**Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortakut themelues të shoqërisë tregtare “**AJ99 Sport and Cultural Management**” shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKET THEMELUES**


**Segun James Adeniyi**



**Olaoynikan Michael Ogunlana**



**Chukwuka Charles Ofojeh**



**Fathiat Oyindamola Adeniyi**



Tiranë, më datë 20.03.2023